

VENDIM
Nr. 28, datë 2.6.2021

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK, PËR ZOTËRIMIN NGA
SHOQËRIA “EUROSIG” SHA TË 21.02 PËR QIND TË KAPITALIT
AKSIONAR TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË SHA**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të shkronjës “h”, të pikës 1, të nenit 24, dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për zotërimin e 21.02 për qind të aksioneve, me të drejtë vote të kapitalit aksionar të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., nga shoqëria “Eurosig” sh.a.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko